



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LIGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës
Mbledhja nr. 13
Prishtinë, më 15 korrik 2011
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENSHME, SIGURI DHE
MBIKQYRJËN E FORCËS SË SIGURISË TË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Fatmir Xhelili, Ganimete Musliu, Goran Marinković, Anton Çuni, Vjollca Krasniqi dhe Rasim Demiri, anëtarë të Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj dhe Haxhi Xhemajli.

Nga stafi këshillues i Komisionit morën pjesë: Avni Arifi dhe Naim Hoxha.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 10.06.2011, 17.06.2011 dhe 24.06.2011;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit përfundimtarë të Projektligjit nr. 04/L-12 për Mbrojtje nga Zjarri;
4. Të ndryshme

***Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 10.06.2011, 17.06.2011 dhe 24.06.2011

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit përfundimtarë të Projektligjit nr. 04/L-12 për Mbrojtje nga Zjarri

Kryetari – Ju e dini që grupi punues e ka kryer punën e vet, komisioni i ka miratuar këtë projektligj. Fjalën ja jap z. Fatmir Xhelili.

Fatmir Xhelili – Siç e thatë edhe ju kryetar, grupi i punues e ka kryer punën e vet për këtë Projektligj dhe është i gatshëm për ta proceduar për lexim të dytë. Ky Projektligj i plotëson të gjitha kushtet për zbatim në vendin tonë dhe besoi që jemi dakord për miratim në seancë.

Kryetari – A ka vërejtje dikush për këtë Projektligj? A pajtoheni të shkoj në procedurë të mëtutjeshme?

Anëtarët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës e miratuan raportin përfundimtarë të Projektligjit nr. 04/L-12 për Mbrojtje nga Zjarri

4. Të ndryshme

Kryetari – A ka dikush diçka për këtë pikë.

Fatmir Xhelili – Unë vetëm kisha deshtë të ndërlihem me monitorimin e ligjit për Ripranim, ku unë jam caktuar referues i grupit të punës dhe kisha propozuar që gjatë javës së ardhshme ta kemi një takim si grup dhe të fillojmë punën se si ta bëjmë monitorimin.

Rexhep Selimi – Unë kisha kërkuar një sqarim nga ju se pse në mbledhjen e kaluar nuk kemi qenë mirë të informuar që ministri i MPB-së është i ftuar në takim dhe si deputet kemi ardhur të papërgatitur që do ta kemi ministrin aty. A është bërë kjo për shkak të ndonjë lëshimi teknik objektiv apo subjektiv.

Kryetari – Për sqarim z. Selimi, për atë mos njoftim të saktë, ka ndodh një keqkuptim me koordinatorin e komisionit gjatë caktimit të agjendës. Personalisht jam ndier keq për këtë mos informim të saktë. Unë kam menduar që ju të gjithë e dini që ministri do të jetë prezent. Agjendën e harton administrata dhe kërkoj që herëve të tjera të jenë më të kujdesshëm në përpilimin e rendit të ditës.

Rexhep Selimi – Nëse ju e merrni përsipër z. Kryetar që ka qenë një keqkuptim unë po pajtohem dhe me vjen mirë që nuk ka qenë ndonjë kabotazh për të cilën kemi arsye për të dyshuar.

Kryetari – Unë ju garantoj se si komision, asnjëherë nuk do të ketë jo transparencë e as ikje nga përgjegjësia. Nuk do të ketë as në të ardhmen dhe nuk e besoi që ka pasur as në të kaluarën. Meqenëse nuk ka pika të tjera për të diskutuar, e mbyll takimin për sot. Ju faleminderit.

Mbledhja përfundoj në orën: 10:35

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi